

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 4, neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe neni 42, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 4, neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-3632/1 datë 22.8.2025 dhe Njoftimin PA1 nr.02-364 datë 16.4.2026 duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.02-108 datë 22.4.2026 në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-1838/6 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi:

## VENDIM

1. **ANULOHET** Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, që lejon ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT ShPK Shkup.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi me ditën e miratimit, dhe publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

## Arsyetim

Në pajtim me nenin 42, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Agjencia me vendim do ta anulojë vendimin me të cilën ka lejuar zbatimin e ndryshimit të strukturës pronësore nëse ndryshimi i strukturës pronësore në Regjistrin Qendror nuk është zbatuar në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të vendimit për zbatimin e ndryshimit të strukturës pronësore.

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 1-rë mbajtur më 14.1.2026, duke vepruar sipas Njoftimit për ndryshim të strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT ShPK Shkup PA1 nr.02-364 datë 30.12.2025 dhe Propozimin nga personi i autorizuar nga drejtori i Agjencisë PA1 nr.02-364 datë 13.1.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-174/5 datë 14.1.2026, miratoi Vendim PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, që lejon ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) RADIO VAT ShPK Shkup, dhe përkatësisht: për heqjen e personit fizik Ekrem Kadri, me NVAQ 1910961450055 dhe adresë në rrugën. „Vanço Mickov“ nr.17B Shkup, me pjesëmarrje prej 50% në kapitalin bazë dhe të personit fizik Mefail Kadri, me NVAQ 2603999450133 dhe adresë në rrugën.„Bajram Miftari“ nr. 3A Shkup, me pjesëmarrje në 50% në kapitalin bazë dhe për hyrjen e personit juridik BASHKËSIA FETARE ISLAME e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me NVAS 4069676 dhe adresë në rrugën.„Çairska“ nr. 52 Çair, Shkup. Në pajtim me pikën 2 dhe 3 të lëndës së vendimit ShTR RADIO VAT ShPK Shkup, detyrohet pas ndryshimit të kryer të strukturës pronësore drejtuar Agjencisë të dorëzoj gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RQRMV), si dhe të zbatoj ndryshimin e miratuar të strukturës së pronësisë në RQRMV në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të Vendimit PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, që lejon ndryshimi të strukturës pronësore.

Afati për zbatimin e ndryshimit të miratuar të strukturës pronësore në RQRMV – 90 ditë nga dita e miratimit të Vendimit PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, për ndryshim të strukturës së pronësisë të ShTR RADIO VAT ShPK Shkup, ka skaduar më 15.4.2026.

Për të kontrolluar nëse transmetuesi veproi sipas Vendimit PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, me të cilën iu lejua ndryshimi i strukturës pronësore më 16.4.2026, nga sektori kompetent i Agjencisë është kryer verifikim në RQRMV, ku është konstatuar se nuk është zbatuar ndryshimi i miratuar në strukturën e pronësisë të ShTR RADIO VAT SHPK Shkup. Në lidhje me të mëparshmen, sektori kompetent drejtuar drejtorit të Agjencisë dorëzoj Njoftimin PA1 nr.02-364 datë 16.4.2026, për ndryshimin e pazbatuar të strukturës pronësore të ShTR RADIO VAT ShPK nga Shkupi.

Prandaj, duke marrë parasysh se transmetuesi nuk ka vepruar në afatin e parashikuar ligjor për zbatimin e ndryshimit të miratuar të strukturës pronësore, Agjencia konstatoi se janë përmbushur kushtet nga neni 42, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për anulimin e Vendimit PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026.

Si pasojë e sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 4, neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10, neni 42, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 4, neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Njoftimin PA1 nr.02-364 datë 16.4.2026, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.02-108 datë 22.4.2026, për miratimin e Vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, për ndryshim të strukturës pronësore të ShTR RADIO VAT ShPK Shkup, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-1838/6 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi Vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.02-364 datë 15.1.2026, për ndryshim të strukturës pronësore të ShTR RADIO VAT ShPK Shkup.

Në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij vendimi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho Stefanofski**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VAT ShPK Shkup, ka të drejtë të paraqesë padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani